REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA HIMARË**
**DREJTORIA JURIDIKE**

Nr.8013prot. Himarë, më 27.10.2025

**Lënda:** Ridërgohet për miratim projektvendimi "Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 2.09 Ha, dhe për një sipërfaqe për "Impiant Betoni" prej 945 m2, në Palasë, Zk:2863, në favor të shoqërisë "DULLA KONSTRUKSION"SH.P.K". për aktivitetin : "Instalim impiant, prodhim betoni dhe aktivitete ndihmëse".

**KESHILLIT BASHKIAK HIMARË,**

**Himarë**

Bazuar ne Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 9, pika 1.2; neni 27, pika 5 dhe nenit 54; VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar "Për transferimin në pronësi të bashkive te pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive" pika 49 ; Ligjit 57/2020, date 30.04.2020 "Për Pyjet", neni 5; VKM nr. 592, datë 09.10.2018 "Për disa ndryshime në VKM nr.1354, date 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor"; VKM nr. 1030, datë 16.12.2015 "Për organizimin dhe formën e pjesëmarrjes së shtetit në investimet strategjike dhe rregullat për krijimin, funksionimin e administrimin e fondit të pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike" (FPPMIS), pikes 1, kreu II, "Fondi i Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS) krijohet nga pasuritë e paluajtshme shtetërore, objekte, truall, tokë bujqësore, pyll, livadhe dhe kullota, në pronësi të institucioneve qendrore apo të njësive të qeverisjes vendore", si dhe në plotësim të vendimit nr.26, datë 27/06/2025 të Këshillit Bashkiak Himarë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë:

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- Projektvendimin "Dhënien e miratimit për dhënien në përdorim nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 2.09 ha dhe për një sipërfaqe për "Impiant Betoni" prej 945 m2, në Palasë, Zk:2863 në favor të shoqërisë "DULLA KONSTRUKSION" sh.p.k., për aktivitetin "INSTALIM IMPIANT, PRODHIM BETONI DHE AKTIVITETE NDIHMËSE".
- Relacion: Mbi projekt vendimin "Dhënien e miratimit për dhënien në përdorim nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 2.09 ha dhe për një sipërfaqe për "Impiant

Betoni" prej 945 m2, në Palasë, Zk:2863 në favor të shoqërisë "DULLA KONSTRUKSION" sh.p.k., për aktivitetin "INSTALIM IMPIANT, PRODHIM BETONI DHE AKTIVITETE NDIHMËSE".

**KRYETARI**
Vangjel Tavo

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**
**ZËVENDËSKRYETARI**
Erifili Berberi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HIMARË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA HIMARË**
**KRYETARI**

Nr.8013/1 prot. Himarë, më 27.10.2025

# PROJEKT-VENDIM

**Nr.54, Datë 27.10/2025**

**"PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR DHËNIEN NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR KULLOSOR TË NJË SIPËRFAQE PREJ 2.09 HA DHE PËR NJË SIPËRFAQE PËR "IMPIANT BETONI" PREJ 945 M$^2$, NË PALASË, ZK:2863 NË FAVOR TË SHOQËRISË "DULLA KONSTRUKSION"SH.P.K" AKTIVITETI: "INSTALIM IMPIANT, PRODHIM BETONI DHE AKTIVITETE NDIHMËSE"**

Bazuar ne Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 9, pika 1.2; neni 27, pika 5 dhe nenit 54; VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar "Për transferimin në pronësi të bashkive te pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive" pika 49 ; Ligjit 57/2020, date 30.04.2020 "Për Pyjet", neni 5; VKM nr. 592, datë 09.10.2018 "Për disa ndryshime në VKM nr.1354, date 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor"; VKM nr. 1030, datë 16.12.2015 "Për organizimin dhe formën e pjesëmarrjes së shtetit në investimet strategjike dhe rregullat për krijimin, funksionimin e administrimin e fondit të pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike" (FPPMIS), pikes 1, kreu II, "Fondi i Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS) krijohet nga pasuritë e paluajtshme shtetërore, objekte, truall, tokë bujqësore, pyll, livadhe dhe kullota, në pronësi të institucioneve qendrore apo të njësive të qeverisjes vendore", si dhe në plotësim të vendimit nr.26, datë 27/06/2025 të Këshillit Bashkiak Himarë; me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë:

## VENDOSI:

1.Dhënien e miratimit për dhënien në përdorim nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 2.09 ha dhe për një sipërfaqe për "Impiant Betoni" prej 945 m2 në Palasë, Zk:2863 në favor të

shoqërisë "DULLA KONSTRUKSION" sh.p.k., për aktivitetin "INSTALIM IMPIANT, PRODHIM BETONI DHE AKTIVITETE NDIHMËSE".

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë dhe administrata, për nënshkrimin e "Kontratës për dhënien në përdorim nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 2.09 ha, dhe për një sipërfaqe për "Impiant Betoni" prej 945 m2, në Palasë, Zk:2863 në favor të shoqërisë "DULLA KONSTRUKSION" sh.p.k., për aktivitetin "INSTALIM IMPIANT, PRODHIM BETONI DHE AKTIVITETE NDIHMËSE", për një afat 3 vjeçar me të drejtë ripërtëritjeje.

3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 55 pika 6.

**KRYETARI**
Vagjel Tavo

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**
**ZËVENDËSKRYETARI**
Erifili Berberi

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA HIMARË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA HIMARË**
**DREJTORIA JURIDIKE**

Nr.8013/2 prot. Himarë, më 27.10.2025

**RELACION:**
**MBI PROJEKT VENDIMIN "PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR DHËNIEN NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR KULLOSOR TË NJË SIPËRFAQE PREJ 2.09 HA HA DHE PËR NJË SIPËRFAQE PËR "IMPIANT BETONI" PREJ 945 M2, NË PALASË, ZK:2863 NË FAVOR TË SHOQËRISË "DULLA KONSTRUKSION"SH.P.K".**

**AKTIVITETI:**

**"INSTALIM IMPIANT, PRODHIM BETONI DHE AKTIVITETE NDIHMËSE"**

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt-Vendimi që po ju paraqesim vjen pasi kemi marrë dhe shqyrtuar një kërkesë nga Shoqëria "DULLA KONSTRUKSION" sh.p.k., për shprehje interesi për të zgjeruar aktivitetin e saj në fushën e "INSTALIM IMPIANT, PRODHIM BETONI DHE AKTIVITETE NDIHMËSE".

Shoqëria ka kryer kërkimet dhe studimet e saj në territorin e bashkisë Himarë ku dhe ka zbuluar një zonë sipas hartës bashkëlidhur këtij relacioni. Pas verifikimeve në terren është vërejtur se kjo përbën një zonë e cila nuk ndikon në mjedis dhe ndodhet larg rrugës kryesore pra rrjedhimisht nuk ka impakt mjedisor pranë rrugës kryesore dhe fshatrave përreth. Në vazhdimin e procedurave dhe hartimin e raportit tekniko ekonomik nga Drejtoria e Bujqësisë, Pyjeve, Kullotave dhe Ujitjes në plotësim të vendimit nr.26, datë 27/06/2025 të Këshillit Bashkiak Himarë si dhe në mbështëtetje të raportit tekniko – ekonomik i vlerësimit sipas procedurave dhe afatit ligjor, për këtë sipërfaqe, kryer nga grupi punës ngritur me urdhër, pasi është kryer dhe dëgjesa publike në fshatin palasë më datë 20/10/2025 ju paraqesim këtë relacion.

**I. Baza Ligjore**

Ky relacion hartohet në zbatim të:

- Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar;
- Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", i ndryshuar;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 625, datë 26.09.2012 "Për dhënien në përdorim të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore";
- Udhëzimeve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për dhënien në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor për qëllime ekonomike ose zhvillimore.

## II. Qëllimi i projekt-vendimit

Ky projekt-vendim synon miratimit për dhënien në përdorim nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 2.09 ha dhe për një sipërfaqe për "Impiant betoni" prej 945 m2 në Palasë, Zk:2863 në favor të shoqërisë "DULLA KONSTRUKSION" sh.p.k., për aktivitetin "INSTALIM IMPIANT, PRODHIM BETONI DHE AKTIVITETE NDIHMËSE".

## III. Përshkrimi i projektit

Shoqëria "Dulla Konstruksion" sh.p.k ka paraqitur një kërkesë pranë Bashkisë Himarë për dhënien në përdorim të sipërfaqes së sipërpërmendur, me qëllim:

- Ndërtimin e një impianti të përkohshëm për prodhimin e betonit;
- Shfrytëzimin e zonës për zhvillimin e aktiviteteve mbështetëse (logjistikë, magazinim etj);
- Përdorimin e tokës pa ndërhyrje të përhershme në strukturën e fondit pyjor.

Kjo kërkesë është e lidhur me projekte infrastrukturore dhe zhvillimore në zonën e Palasës, e cila ka njohur rritje të ndjeshme të kërkesave për materiale ndërtimi për shkak të zhvillimeve turistike dhe urbane.

## IV. Argumentimi dhe përfitimet

Dhënia në përdorim në mënyrë të kontrolluar dhe të përkohshme e kësaj sipërfaqeje ka për qëllim:

- Mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturor të zonës;
- Rritjen e punësimit dhe të të ardhurave për komunitetin lokal;
- Zhvillimin e kontrolluar të veprimtarisë industriale pa cënuar ekosistemin pyjor në mënyrë të përhershme.

Në çdo rast, përdorimi i sipërfaqes do të jetë i kushtëzuar me:

- Marrjen e lejeve mjedisore dhe urbanistike sipas legjislacionit në fuqi;

- Marrjen e miratimit përfundimtar nga autoritetet përgjegjëse pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik;
- Ngritjen e urdhrave përkatës për zyrat që janë të ngarkuara nga ligji për hartimin e raporteve tekniko ekonomike.
- Zhvillimin e aktivitetit në përputhje me planin lokal të menaxhimit të territorit dhe zonave pyjore.
- Rikthimin e sipërfaqes në gjendjen e mëparshme.

**V. Përfundime dhe propozim**

Duke vlerësuar kërkesën dhe qëllimin e aktivitetit, si dhe duke marrë në konsideratë rëndësinë e zhvillimeve në zonën e Palasës për turizmin dhe ekonominë vendore, **Bashkia Himarë propozon** miratimin për dhënien në përdorim nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 2.09 ha dhe për një sipërfaqe për "Impiant betoni" prej 945 m2 në Palasë, Zk:2863 në favor të shoqërisë "DULLA KONSTRUKSION" sh.p.k., për aktivitetin "INSTALIM IMPIANT, PRODHIM BETONI DHE AKTIVITETE NDIHMËSE".

Miratimi në parim nuk përbën të drejtë për përdorim përfundimtar pa përmbushjen e kushteve ligjore dhe teknike të përcaktuara nga ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

Këshilli Bashkiak i Himarës është i ftuar të shqyrtojë dhe të aprovojë këtë projekt vendim për të mundësuar implementimin e projekteve të mëdha infrastrukturore që do të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe social të zonës.

Bashkëlidhur këtij relacioni:

1. Kopje e hartës topografike me konturet e zonës ku kërkohet të ushtrohet aktiviteti.
2. Kopje e kërkesës së shoqërisë "Dulla Konstruksion" sh.p.k.
3. Raport "Për vijimin e procedurave dhe hartimin e raportit tekniko-ekonomik për një sipërfaqe për zhvillim prej 2.09 ha dhe për një sipërfaqe për "Impiant Betoni" prej 945m$^2$, të shoqërisë "DULLA Konstuksion"sh.p.k.
4. Proces verbal i dëgjesës publike nr.7340/1.

**KRYETAR**
Vangjel Tavo

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**
**ZËVENDËSKRYETARI**
Erifili Berberi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA HIMARË**
**DREJTORIA E BUJQËSISË, PYJEVE, KULLOTAVE DHE UJITJES**

Nr. 5701/1 prot. Himarë, më 01.08.2025

**MIRATOI**
**KRYETAR**
**Vangjel Tavo**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**
**ZËVENDËS KRYETARI**
**Pervin Gjikuria**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HIMARË

## RAPORT TEKNIKO-EKONOMIK PËR NJË SIPËRFAQE PREJ 2.09 HA, TË SHOQËRISË "DULLA KONSTRUKSION" SH.P.K"

Në përgjigje të kërkesës nr. 2844 prot., datë 03.04.2025, të Shoqërisë "DULLA KONSTRUKSION" sh.p.k, për një sipërfaqe për zhvillim prej 2.09 ha dhe për një sipërfaqe për "Impiant betoni" prej 945 $m^2$, në ngastrën nr. 5, ekonomia kullosore "Fajeo", bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 29.07.2022, "Për përcaktimin e tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore."dhe Urdhërit nr. 416, datë 23.07.2025, të kryetarit të bashkisë, "Për vijimin e procedurave dhe hartimin e raportit tekniko-ekonomik" po përpilojmë raportin tekniko-ekonomik si më poshtë:

Mbështetur në planrilevimin ku do zhvillohet projekti dhe në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor rezulton që sipërfaqja e kërkuar është 2.09 ha. Shtrihet në zonën kadastrale 2863 ngastra pyjore Nr. 5 të ekonomisë kullosore "Fajeo" dhe është në pronësi/administrim te Bashkisë Himarë.

Përshkrimi parcelar i sipërfaqes së objektit studimit dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në aneksin 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rrezulton kjo gjendje: (sipas tabelave përkatëse)

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga Shoqëria "DULLA KONSTRUKSION" sh.p.k nuk ndryshojnë kategorinë e përdorimit dhe jepen në përdorim për një afat 3 (tre) vjecar (për një sipërfaqe për zhvillim prej 2.09 ha dhe për një sipërfaqe per "Impiant betoni" prej 945 $m^2$, (brenda kësaj sipërfaqeje).

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në V.K.M nr. 1353, date 10.10.2008, të ndryshuar "Për rregullat për paraqitjen e

kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", në VKM nr. 1374, datë 10.10.2008, të ndryshuar "Për rregullat dhe procedurat e kërkimit ,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe aktiviteteve të tjera normative si më sipër, shoqëria kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur, vetëm pas lidhjes së kontratës me Bashkinë Himarë, dhe likujdimin e tarifës përkatese siç është përcaktuar në këtë raport dhe në kontratën përkatese.

Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 29.07.2022, "Për përcaktimin e tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore.", bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës në kategorinë e përdorimit. Shuma në lek/vit konsiston në:

a) **Vlerën e përdorimit lek/vit për 2.09 ha = 209.000 lekë/vit**

Trungishte ___________ ha x _______lek/ha = _____ leke
Cungishte ___________ha x _________lek = ______leke
Shkurre ____________ha x ________ lek = ______ leke
**Inproduktive 2.09 ha x 100.000 lek/ha = 209.000 lekë**

Përshkrimi parcelar i sipërfaqes së objektit studimit dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në aneksin 1, 2 dhe 3 të këtij raporti.

**PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO – EKONOMIK**

| | | |
|---|---|---|
| **z. Ilia Gika** | **Ing. Ilia Dhimojani** | **Ervis Halilaj** |

Bashkia Himare

PASQYRA E PERSHKRIMIT PARCELAR SIPAS REGJISTRIT KADASTRAL

| ID e Prones | EKONOMIA KULLOSORE | Parcela | Perberje e Grumbullit | Funksioni | Forma e Qeverisjes | Te dhena te grumbullit pyjor | | | | | | | Fuqia Lendore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | KL/M | K.D | D.m | Lart. Mesat. | Filizeria | Nen Pylli | Katet | Per ha DZ | Total |
| VL0600005 | FAJEO | 5 | Inproduktive | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | |
| | TOTALI | | | | | | | | | | | | | |

PASQYRA E PERSHKRIMIT PARCELAR SIPAS VERIFIKIMIT NE TERREN

| ID e Prones | Ekonomia KULLOSORE | Parcela | Perberje e Grumbullit | Funksioni | Forma e Qeverisjes | Te dhena te grumbullit pyjor | | | | | | | Fuqia Lendore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | KL/M | K.D | D.m | Lart. Mesat. | Filizeria | Nen Pylli | Katet | Per ha DZ | Total |
| VL0600005 | FAJEO | 5 | Inproduktive | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | |
| | TOTALI | | | | | | | | | | | | | |

Bashkia Himare

TABELA PERMBLEDHESE E VLERESIMIT FINANCIAR

| Perdorimi i Territorit | Sip.ha | Bashkia | Volumi m3 sipas asortimenteve | Vlera | | Gjatesia Perd.km | Tarifa dhenie ne perdorim lek/km/vit | | | Shuma II | Totali I + II leke |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Himare | | Leke/m3 | Shuma I | | 1 | 2 deri 5 | 6 deri10 | | |
| 0 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| Trungishte | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | |
| Cungishte | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | |
| Shkurre | | | | | | | | | | | |
| Kullota | | | | | | | | | | | |
| Sip me bimesi pyjore + djerr | | | | | | | | | | | |
| Inproduktive | 2.09 ha | | | | | | | 100.000 | | | 209.000 |
| Bime mjek/med | | | | | | | | | | | |
| Gjuetia | | | | | | | | | | | |
| Invest realizuar | | | | | | | | | | | |
| TOTALI | 2.09ha | | | | | | | | | | 209.000 |

Bashkia Himare

LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TE FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK QE HIQEN/JEPEN NE PERDORIM SHOQERISE DULLA KONSTRUKSION"SH.P.K"

Formulari 5

| Nr | ID e Prones | Ekonomia Pyjore/Kullosor | Ng/n/ngast | Siperfaqja qe hiqet nga fondi pyjor, kullosor ha | Siperfaqja qe jepet ne perdorim nga fondi pyjor/kullosor | Gjatesia ne perdorim km | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Rruge | Linje | Tubacion/kanal |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 |
| 1 | VL0400005 | FAJEO | 5 | | 2.09 Ha | 0, Km | | |
| 2 | | | | | | | | |
| 3 | | | | | | | | |
| 4 | | | | | | | | |
| 5 | | | | | | | | |
| 6 | | | | | | | | |
| 7 | | | | | | | | |
| 8 | | | | | | | | |
| | | | | 0 | | 0 | 0 | 0 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA HIMARË**

Nr. 1340 prot.                                                  Himarë, më 20.10.2025

**PROCESVERBAL**

**PËR**

**"Dëgjesë publike me banorët për miratimin e projektvendimi "Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 2.09 Ha, dhe për një sipërfaqe për "Impiant Betoni" prej 945 m2, në Palasë, Zk:2863, në favor të shoqërisë "DULLA KONSTRUKSION"SH.P.K". për aktivitetin : "Instalim impiant, prodhim betoni dhe aktivitete ndihmëse"**

| Njësia administrative | Data | Ora | Vendi ku zhvillohet dëgjesa | Struktura organizatore |
|---|---|---|---|---|
| Himarë | 17.10.2025 | 11:00 | Në qendër të fshatit Palasë, Himarë | DREJTORIA E BUJQËSISË, PYJEVE, KULLOTAVE DHE UJITJES. |

| PJESËMARRJA | | |
|---|---|---|
| Nga Bashkia Himarë | Nga komuniteti | |
| | Lista me pjesëmarrës bashkëngjitur | |
| Drejtoria Juridike- z. Ardit Muhametaj | ______________ | ______________ |

| | | |
|---|---|---|
| Përfaqësues të drejtorisë së Pyje Kullotave<br><br>Përfaqësue nga fshati Palasë | __________<br>__________ | __________<br>__________ |

- **Tematika për diskutim:**

Diskutim për dakortësinë në lidhje me vendndodhjen e propozuar për dhënien në përdorim të sipërfaqes të përmendur, me qëllim:

- Ndërtimin e një impianti të përkohshëm për prodhimin e betonit;
- Shfrytëzimin e zonës për zhvillimin e aktiviteteve mbështetëse (logjistikë, magazinim etj);
- Përdorimin e tokës pa ndërhyrje të përhershme në strukturën e fondit pyjor.

**Zhvillimi i dëgjesës**

Dëgjesa publike konsiston kryesisht me marrjen e mendimeve të banorëve dhe të interesuarve në lidhjen me vendndodhjen e propozuar për dhënien në përdorim të sipërfaqes të përmendur, me qëllim:

- Ndërtimin e një impianti të përkohshëm për prodhimin e betonit;
- Shfrytëzimin e zonës për zhvillimin e aktiviteteve mbështetëse (logjistikë, magazinim etj);
- Përdorimin e tokës pa ndërhyrje të përhershme në strukturën e fondit pyjor

**Përfaqësuesit e BAshkisë Himarë-** Ju falenderojmë për pjesëmarrjen. Jemi këtu për te diskutuar dhe për të marrë mendime për këtë propozim me iniciator dhe investitor shoqërisë "DULLA KONSTRUKSION"SH.P.K". për aktivitetin : "Instalim impiant, prodhim betoni dhe aktivitete ndihmëse".

**Komentet e banorëve dhe përfaqësuesve të tjerë:**

**Banorë të zonës-** Si banor i fshatit kërkoj të marr informacion dhe të jap mendim që këto prona janë ende të pa pajisuara me dokument pronësor. Jap mendim që të realizohet procesi i regjistrimit përfundimtar të këtyre pasurive që mund të preken nga ky projekt në mënyrë që më tej të realizohet procesi i duhur në lidhje me pjesët e pronave edhe pse dalin shtet janë të qytetarëve që preken nga këto ndërtime.

**Banor i fshatit-** Jam banor i kësaj zone dhe i kërkoj Bashkisë që të shikojë dhe alternativa të tjera për zhvillimin e këtij projekti pasi duhet patur kujdes me pronat dhe pretenduesit e pronave.

Në vazhdimësi të bashkëbisedimit përfaqësuesit e Bashkisë shprehën impenjimin maksimal që së bashku me organet përkatëse ASHK dhe ATP të konfirmojnë çdo dokumentacion pronësie në këtë fazë të projekt idesë përpara se të ndërmarrin veprime të tjera.

**Banorë të zonës** – zona ku propozoni nuk është në dukje qoftë nga rruga qoftë nga deti dhe nuk e pengon turizmin. Ngre shqetësimin dhe për kanalet kulluese që jan të bllokuara. Duhet parë me shum kujdes dhe rruga nga do kalojnë automjetet. Nuk është se këmi ndonjë kundërshtim.

**Banor i fshatit**– Ky projekt duhet që krahas lehtësive që krijon për ndërtuesit të përkthehet në investime për fshatin Palasë.

**Banor i fshatit** - Bashkia duhet të lidhë marrëveshje më investitorët që punojnë të territorin tonë që të invenstojnë në rrugët dhe kanalet e fshatit.

**Banor i Fshatit**- Në parim jemi dakortt me projektin që keni propozuar që të bëhet në zonën e Palasës por duhet zgjidhur dhe problemi i rregjistrimit të tokave në mënyrë që të qartësohen dhe banorët të cilët i prek ky projekt.

Përfaqësues të shoqërisë bënë një prezantim të shkurtër teknik të propozimit të gjurmës në hartë ku paraqitën dhe hartën treguese të zonës që propozohet të preket nga ky projekt, duke marrë parasysh opinionet e interesuarve që kanë pronat ose i pretendojnë në këto gjurmë.

**Përfundimi i dëgjesës:**

Përfaqësuesit e Bashkisë, shprehën angazhimin e tyre për t'u adresuar të gjitha shqetësimet e ngritura para vazhdimit të projektit. Pjesëmarrësit u falenderuan për mendimet e dhëna dhe u theksua se projekti do të realizohet vetëm pasi të zgjidhen verifikimet e pronësisë dhe të tjera të shprehura nga banorët.

**Mbyllja:**

Takimi përfundoi me falënderimin e pjesëmarrësve dhe mbledhjen e nënshkrimeve të tyre.

**MBAJTËS I PROCESVERBALIT**

**DREJTORI JURIDIK**

Ardit Muhametaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË


Palasë, më 17.10.2025

Listeprezenca

Dëgjesë publike ''Për dhënien e miratimit për dhënien në përdorim nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 2.09 ha dhe për një sipërfaqe për 'Impant betoni' prej 945 m2 në Palasë,ZK:2863 në favor të shoqërisë ,'Dulla Konstruksion' sh.p.k, për aktivitetin: ''INSTALIM IMPIANT,PRODHIM BETONI DHE AKTIVITETEVE NDHIHMËSE''datë 17.10.2025, ora-11:00, vendi: Fshati Palasë,Himarë.

| Nr | Emër Mbiemër | Nr tel | Firma |
|---|---|---|---|
| 1 | Altin Musaj | 0693759212 | [signature] |
| 2 | Admir Cerskollari | 069273254 | [signature] |
| 3 | Ilir QEFA | 0676999000 | [signature] |
| 4 | LENC HOXHA | 0694532282 | [signature] |
| 5 | Alfred Bea | 0696111314 | [signature] |
| 6 | Imon Lulaj | 0682281952 | [signature] |
| 7 | Jeti Holisaj | 0697024699 | [signature] |
| 8 | Oltion Kullolli | | [signature] |
| 9 | Elvis Kofi | 0672069690 | [signature] |
| 10 | Kristjan Bregasi | 0696842217 | [signature] |
| 11 | Daniel Xhelaj | 0684464941 | [signature] |
| 12 | Mihail Zhu | 0683027723 | [signature] |
| 13 | ZIHO VLASHI | 0674000036 | [signature] |
| 14 | MIREL META | 0698145022 | [signature] |
| 15 | Assaf Binder | 0697485004 | [signature] |
| 16 | Aneta Duni | 0682145666 | [signature] |
| 17 | ilir Vlashi | 0672851323 | [signature] |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 18 | Zola Vloshi | 0693124788 | [signature] |
| 19 | Meri Vloshi | 0682231458 | [signature] |
| 20 | Morgarita Kristo | 0684532931 | [signature] |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |
| 24 | | | |
| 25 | | | |
| 26 | | | |
| 27 | | | |
| 28 | | | |
| 29 | | | |
| 30 | | | |
| 31 | | | |
| 32 | | | |
| 33 | | | |
| 34 | | | |
| 35 | | | |
| 36 | | | |
| 37 | | | |
| 38 | | | |
| 39 | | | |
| 40 | | | |
| 41 | | | |
| 42 | | | |
| 43 | | | |
| 44 | | | |
| 45 | | | |
| 46 | | | |







Drejtoria e bujqësisë
Drejtoria juridike
03.04.2025

BASHKIA HIMARË
Nr. 2844 Prot.
Datë,më 03.04. 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE E INFORMACIONIT DHE E SHËRBIMEVE DIGJITALE
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE INFORMACIONIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Data e kërkesës | 03-04-2025 |
| 2. | Emri, Mbiemri | Albert Dallaku |
| 3. | Vendbanimi | Kurvë |
| 4. | Numër telefoni | 0694057774 |
| 5. | Lloji i kërkesës | |
| 6. | Ku adresohet kërkesa | Bashkia Himarë |
| 7. | Dorëzimi i përgjigjes me e-mail, postë ose në panel | PPZhT/juridike |

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Data e regjistrimit | 03.04.2025 |
| 2. | Numër regjistri | 968 |
| 3. | Data e marrjes nga drejtoria\zyra | 04.04.2025 |
| 4. | Të dhënat për tatim-taksat | |
| 5. | Personi përgjegjës për trajtimin | |
| 6. | Të tjera | |
| | | |

**Bashkëngjitur kërkesës këto dokumenta:**

**Punonjës i informacionit**
Grigor Shora
*(emër, mbiemër, firmë)*

**Përshkrimi i kërkesës/ankesës:**

Kërkoj një sipërfaqe toke me Qera nga Bashkia Himarë për zhvillimin e kantjerit "IMPIANT BETONI" Zona sipas Hartës Bashkëngjitur"

**KËRKUESI**
Albert Dallaku



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Mbiemri/Surname
Dallaku
Albert
Shqiptare/Albanian
Krujë, ALB
02-10-1981
15-10-2020
MPB
036514969
M
14-10-2030
I11002049G
Albert Dallaku

ark. JETNOR MEMLIKAJ
Adresa: RRUGA PANAJOT PANO TIRANE
Cel: 0672067915
E-mail: jetnormemlikaj@gmail.com

## DEKLARATA E PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE

## ARKITEKT

Unë, i/e nënshkruari/a JETNOR MEMLIKAJ , me profesion Arkitekt, me licensë profesionale Nr.A1177/3, deklaroj me vullnetin tim të lirë e të pakushtëzuar dhe nën përgjegjësinë time të plotë, se kam hartuar projektin arkitektonik për objektin:

OBJEKTI : "INSTALIM IMPIANT PRODHIM BETONI DHE AKTIVITETE NDIHMESE"

INVESTITOR : DULLA KONSTRUKSION SHPK ME NIPT L32822801B

ADRESA: PALASË, BASHKIA HIMARË

në përputhje me të gjitha dokumentet e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të zbatueshme, si dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

**(Jetnor MEMLIKAJ)**

Arkitekt / Lic - A.1177/3

*(Nënshkrimi elektronik)*

Jetnor Memlikaj
Digitally signed by Jetnor Memlikaj
Date: 2025.03.25 09:32:12 +02'00'

HAZBI ISMAILI

DULLA KONSTRUKSION
Qerret
Ndërtime dhe Tregti
Nipt: L32822801B

# AKT MARRËVESHJE

Shoqëria "LAERTI TRANS" sh.p.k, NUIS L24603201F ka si objekt të aktivitetit: "Transport kombetar dhe nderkombetar, te karburanteve dhe lendes djegese.Import – eksport, dhe tregti me pakice te karburanteve. Transport kombetar dhe nderkombetar te mallrave industriale dhe ushqimore, materialeve dhe te gjitha sherbimet...etj".

Shoqëria "DULLA KONSTRUKSION" sh.p.k, NUIS L32822801B, ka si objekt të aktiviteti: "Aktivitete ne fushen e ndertimit , ndertim objektesh civile dhe publike, vepra arti, rruge etj, nyje betoni , prodhim inertesh, tregtim me shumice dhe pakice te lendeve te ndryshme qe sherbejne ne ndertim si, hekur, çimento, llaç i pergatitur etj".

Midis këtyre shoqërive më sipër, lidhet kjo akt marrëveshje paraprake për bashkëpunim në fushën e ndërtimit, referuar objektit të veprimtarisë së secilës shoqëri tregtare, sipas rregjistrimit përkatës në Qendrën Kombëtare të Biznesit, nën termat si më poshtë:

a) shoqëria "LAERTI TRANS" sh.p.k merr përsipër të furnizojë në vazhdimësi shoqërinë "DULLA KONSTRUKSION" sh.p.k me materiale ndërtimi, siç janë inerte, granil, çimento, etj, sipas nevojave dhe kërkesave të këtaj të fundit dhe akordit paraprake midis palëve për çdo ngarkesë;

b) çmimet e furnizimeve periodike dhe të shërbimeve të tjera, do të specifikohen prej palëve në aktet e lëshuara për këtë qëllim (faturat e shërbimit) sipas Ligjit Nr. 9901/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet e dala në zbatim të këtij ligji;

c) pala e dytë, shoqëria "LAERT TRANS" sh.p.k merr përsipër që të sigurojë vendin e realizimit të aktivitetit si më sipër, konkretisht, parcelës me emrin popullor "Përroi i Thatë", ZK 2863, Bashkia Himarë, Fshati Palasë, Qarku Vlorë, me koordinata gjeografike të përcaktuara, në një afat që palët do ta përcaktojnë me marrëveshje midis tyre;

ç) kjo akt marrëveshje paraprake krijon efekte ligjore nga dita e nënshkrimit të saj prej përfaqësuesve ligjorë të dy shoqërive "LAERTI TRANS" sh.p.k dhe "DULLA KONSTRUKSION" sh.p.k dhe mund të depozitohet tek të tretët si akt i vullnetit të këtyre

"LAERTI TRANS" Sh.p.k.
NIPT L24603201 F
Kruja - Albania

DULLA KONSTRUKSION
Qerret - Kavajë
Ndërtime dhe Tregti
Nipt: L32822801B

palëve (shoqërive tregtare) për realizimin e bashkëpunimit të vazhdueshëm në projekte të përbashkëta në fushën e ndërtimit.

d) kjo akt marrëveshjeje, si shprehje e vullnetit të mirë dhe të pavesuar, lidhet pa afat dhe palët mund të tërhiqen në çdo kohë nga kjo akt marrëveshje, duke respektuar procedurat standarte ligjore të zgjidhjes së kontratës së dyanshme, përmes një njoftimi paraprak të palës tjetër.

e) përveç sa më sipër, palët në këtë akat marrëveshje rezervojnë të drejtat respektive për të amenduar kushtet e kësaj marrëveshjeje, në përputhje me realitetin potencial të ri të marrëdhënies midis tyre, brenda objektit të aktivitetit, për të cilin është rënë dakort si më sipër.

Kjo akt marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe dhe në 2 (dy) kopje për secilën palë nënshkruese të saj.

**Tiranë, më 03.04.2025**

| **Shoqëria "LAERTI TRANS" sh.p.k** | **Shoqëria "DULLA KONSTRUKSION" sh.p.k** |
|---|---|
| **Administratori** | **Administratori** |
| "LAERTI TRANS" Shpk<br>NIPT 24603201 F | HAZBI ISMAILI |
| Albert Dollaku | DULLA KONSTRUKSION<br>Qerret - Kavajë<br>Ndërtime dhe Tregti<br>Nipt: L32622801B |



## HARTA TOPOGRAFIKE ME KUFIJTË E ZONËS SË KËRKUAR
Per mineralin gur gelqeror, Objekti "Palasa 1", Bashkia Himare.




| Nr | Y | X |
|---|---|---|
| 1 | 4381612 | 4450253 |
| 2 | 4381515 | 4450280 |
| 3 | 4381516 | 4450462 |
| 4 | 4381638 | 4450440 |
| 5 | 4381632 | 4450367 |
| S = 0.0209 km2 ( 2.09 ha) | | |

Table: KOORDINATAT E ZONES

Shënime:
1. Sistemi Koordinativ :K.RR.GJ.SH

| | |
|---|---|
| Faza | PROJEKT ZBATIMI |
| Titulli i Projektit | OBJEKTI : "INSTALIM IMPIANT PRODHIM BETONI DHE AKTIVITETE NDIHMESE" INVESTITOR : DULLA KONSTRUKSION SHPK NIPT L32822801B |
| Projektuas | |
| Arkitekt | Jetnor Memlikaj — Nr. Lic. A.1177/3 |
| Arkitekt | Amarildo Karaj |
| Emërtimi i Fletës | PLANI I RIVEVIMIT — ARK -Fleta nr:1-20 |
| Shkalla | 1:1000 / 1:25000 |
| Data | MARS 2025 |
| Nënshkrimi elektronik | |

# PROJEKTI ARKITEKTONIK

OBJEKTI : "INSTALIM IMPIANT PRODHIM BETONI DHE AKTIVITETE NDIHMESE"

INVESTITOR : DULLA KONSTRUKSION SHPK ME NIPT L32822801B.

ADRESA: PALASË , BASHKIA HIMARË



Arkitekt Jetnor Memlikaj Nr. Liç. A.1177/3

| | |
|---|---|
| Faza | PROJEKT ZBATIMI |
| Titulli i Projektit | OBJEKTI : "INSTALIM IMPIANT PRODHI BETONI DHE AKTIVITETE NDIHMESE<br>INVESTITOR<br>DULLA KONSTRUKSION SHP<br>NIPT L32822801 |
| Projektues | |
| Arkitekt | Jetnor Memlikaj — Nr. Liç. A.11 |
| Arkitekt | Amarildo Karaj |
| Emërtimi i Fletës | KAPAKU — Ark -Fleta nr:1 |
| Shkalla | 1:100 |
| Data | MARS 2025 |
| Nënshkrimi elektronik | |

**PLANVENDOSJA E STRUKTURËS : "INSTALIM IMPIANT PRODHIM BETONI DHE AKTIVITETE NDIHMESE" NË PASURINË ME NR.-------, ZONA KADASTRALE ------- ME ADRESË PALASA 1 , BASHKIA HIMARË NË PRONË TË BASHKISË HIMARË ME ZHVILLUES SHOQËRINË DULLA KONSTRUKSION SHPK DHE ME INVESTITOR SHOQËRINË DULLA KONSTRUKSION SHPK**




**TREGUESIT PËR ZHVILLIM :**

-PARCELA PËR ZHVILLIM NR. PASURIE SIP = 20.922 HA
-TOKA - PRONE SHTET (BASHKIA HIMARË)
-SIP. E GJURMES + HAPESIRE MANOVRIMI = 945 $m^2$
-SIP TOTALE E IMPJANTIT + AMB. MBESHTETESE = 945 $m^2$
-H-MAX E OBJEKTIT = 15.8 m (Sillosi)

**TREGUESIT E DISTANCAVE :**

- DISTANCAT NGA KUFITI I PRONËS
  - -Veri -m
  - -Lindje -m
  - -Jug -m
  - -Perëndim -m
- DISTANCAT NGA NDËRTIMET:
- DISTANCAT NGA RRUGËT:
  - -Veri -m

**KONDICIONET URBANE**

KONDICIONET URBANE SIPAS PPV

Njësia Strukturore: HI.N.166

Bashkia Himarë
Njësia HI.N.166
Sistemi N_Natyror
Kategori 1 N. Natyrë
Lartësia në Kate K1=0
Lartësia në Metra K1=0
PDV JO
Intesitet K1=0
KSHT K1=0 %
KSHR 0%
KSHP 0%
Kufizime Ligjore -
Sipërfaqe (ha) 200.70
Nenkategori 1 N.5_Zona të mbrojtura peisazhistike
Parcela_Minimale K1=0 m2
Përdorime të Lejuara B.2_Tokë bujqësore primare kodrinore (ullishte,pemëtore,vreshtë)
Përdorime të Ndaluara A_Banim; S_Shërbime
Kushte të Tjera



**MIRATOHET**

Nr.VENDIMI __________ Dt. / /

KRYETARI I BASHKISË HIMARË

Z.VANGJEL TAVO

DREJTOR D.P.K.ZH

POZICIONI KADASTRAL SH 1: 5000
SIP 20.922 HA




KADASTRA URBANE SH 1: 50000



**VENDODHJA E PARCELES PËR ZHVILLIM SH 1: 1000**



| | |
|---|---|
| OBJEKTI: INSTALIM IMPIANT PRODHIM BETONI DHE AKTIVITETE NDIHMESE ME ADRESË PALASË, BASHKIA HIMARË | |
| INVESTITOR : DULLA KONSTRUKSION SHPK | |
| VENDODHJA: PALASA 1 | |
| FAZA : LEJE ZHVILLIMI | |
| PLANI I VENDOSJES SË STRUKTURËS | Nr.i fletës U-01 |
| PROJEKTUES | |
| ARK. JETNOR MEMLIKAJ | NR.LIÇ A.1177/3 |

# Rilevimi i Prones Dhe Profilat terthore te saj











| | |
|---|---|
| Faza | PROJEKT ZBATIMI |
| Titulli i Projektit | OBJEKTI : "INSTALIM IMPIANT PRODHIM BETONI DHE AKTIVITETE NDIHMESE"<br>INVESTITOR :<br>DULLA KONSTRUKSION SHPK<br>NIPT L32822801B |
| Projektues | |
| Arkitekt | Jetnor Memilaj — Nr. Liç. A.1177 |
| Arkitekt | Amerlido Kera |
| Emërtimi i Fletës | ARK -Fleta nr:1- |
| | PLANI I RIVEVIMIT<br>PRERJE TERTHORE |
| Shkalla | 1:1250 |
| Data | MARS 2025 |
| Nënshkrimi elektronik | |

# PLANI I PERGJITHSJHEM SH 1 :200




LEGJENDA

Kufiri i Pronës sipas Hartës Treguese dhe matjeve faktike

Hapesire e nevojshme per impiantin

Kuota e Tokës

Pemë

izoipse

Hyrje ne prone

Linjë elektrike

Rrugë

| | |
|---|---|
| Faza | PROJEKT ZBATIMI |
| Titulli i Projektit | OBJEKTI : "INSTALIM IMPIANT PROD... BETONI DHE AKTIVITETE NDIHMI... |
| | INVESTIT... DULLA KONSTRUKSION S... NIPT L328228... |
| Projektues | |
| Arkitekt | Jelnar Memlikaj — Nr. Lic. A.11... |
| Arkitekt | Amarildo Karaj |
| Emërtimi i Fletës | ARK -Fleta nr... |
| | PLANI I PERGJITHSHEM |
| Shkalla | 1:200 |
| Data | MARS 2025 |
| Nënshkrimi elektronik | |

# PAMJE E OBJEKTIT SH 1: 100




Faza
PROJEKT ZBATIMI

Titulli i Projektit

OBJEKTI : "INSTALIM IMPIANT PRODH
BETONI DHE AKTIVITETE NDIHME

INVESTITO
DULLA KONSTRUKSION SH
NIPT L3282280

Projektues

| | | |
|---|---|---|
| Arkitekt | Jatmor Mamilkaj | Nr. Lic. A. |
| Arkitekt | Amarildo Karaj | |

Emërtimi i Fletës — Ark.-Fleta n

PAMJE TE OBJEKTIT

Shkalla
1:100

Data
MARS 2025

Nënshkrimi elektronik

# PAMJE E OBJEKTIT SH 1: 100

## PAMJE ANESORE







## PAMJE NGA SIPER




| | |
|---|---|
| Faza | PROJEKT ZBATIMI |
| Titulli i Projektit | OBJEKTI : "INSTALIM IMPIANT PRO BETONI DHE AKTIVITETE NDIHM<br>INVESTI<br>DULLA KONSTRUKSION .<br>NIPT L32822 |
| Projektues | |
| Arkitekt | Jetnor Mamlikaj — Nr. Lic. A |
| Arkitekt | Amarildo Karaj |
| Emërtimi i Fletës | PAMJE TE OBJEKTIT — Ark -Fleta n |
| Shkalla | 1:100 |
| Data | MARS 2025 |
| Nënshkrimi elektronik | |

# MODULI I AGREGATIT (PJESET PERBERESE)




## Skeda teknike

| Nr. | Përshkrimi | Nr. | Përshkrimi | Nr. | Përshkrimi | Nr. | Përshkrimi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Karikues | 8 | paisje peshimi | 15 | Ganxhe mbyllese | 22 | Kit cilindri |
| 2 | Tube gome | 9 | Kompresor ajri | 16 | Tube gome i zi | 23 | Kit cilindri |
| 3 | Valvul flutur e kompletuar DN 200 | 10 | Panel elektrik | 17 | Tube PVC | 24 | Cilinder i kompletuar |
| 4 | Valvul DN 200 | 11 | Vibrator | 18 | Komplet veshje mbrojtese | 25 | Kit i kompletuar dere |
